



TI NUK JE VETËM

Në të gjithë vendin janë duke u zbatuar rregulla të qarta për distancimin fizik ndërmjet njëri-tjetrit, si një mënyrë për të mbrojtur veten dhe individët e tjerë rreth nesh.

Organizimi dhe përshtatja në aktivitetet e përditshme dhe situatat e reja të krijuara janë aftësi natyrale të njeriut, por gjithmonë në bazë të kapaciteteve dhe potencialeve njerëzore që gjithsecili prej nesh ka, në përshtatje me ritualet e tjera.

Një kategori e veçantë që mund të hasi vështirësi në përshtatje, janë dhe nxënësit me aftësi të kufizuara dhe padyshim edhe familjarët e tyre. Vendosja e një strukture të përcaktuar ditore i ndihmon ata për të ulur nivelin e ankthit dhe për të ndërvepruar më lehtësisht brenda kapaciteteve të tyre të zhvillimit.

Gjatë kësaj periudhe është e vështirë mbajtja apo ndjekja e strukturës së ngritur dhe pamundësia për të marrë shërbimin e nevojshëm profesional, terapeutik do të shtojë nivelin e ankthit dhe të pasigurisë tek ta.

Kjo pasqyrohet në mungesën e përfshirjes së tyre në platformën online të të mësuarit. Është e rëndësishme gjetja e teknikave të cilët do të bënin bashkë online edhe grupin multidisiplinar brenda shkollës.

NDËRTOJMË SË BASHKU NJË KOMUNIKIM

Në mbështetje të nxënësve me aftësi të kufizuara.

Punonjësit e shërbimit psiko-social në bashkëpunim me mësuesit ndihmës, do të jenë të koordinuar dhe të ndarë në grupe pune, për t'ju ardhur në ndihmë të gjithë nxënësve me nevoja të veçanta me qëllim përfshirjen e tyre në kushtet e mësimit on line.

Synimi i kësaj platforme është integrimi i nxënësve me aftësi të kufizuar duke ofruar këshilla praktike, materiale didaktike virtuale të fokusuara në aspektin e të nxënësve, strukturimin dhe menaxhimin e sjelljes përgjatë situatës aktuale në të cilën ndodhemi, e në vijimësi.

Kjo ndihmë do të organizohet në katër linja kryesore:

I. Materiale teorike të grupuara sipas çrregullimeve dhe grupmoshave

- Në fokus të kësaj rubrike do të jenë materiale teorike të grupuara sipas diagnozave dhe specifikave që shfaq secila prej tyre.
- Dhënien e këshillave specifike sipas diagnozave.
- Materiale praktike për secilën diagnozë në mënyrë të dedikuar për:
 - *Menaxhimin e sjelljes,*
 - *Menaxhimin e kohës,*
 - *Menaxhimin e problematikave emocionale,*
 - *Materiale për hiperaktivitetin dhe mungesën e përqendrimit.*

II. Materiale didaktike në ndihmë të fëmijëve.

- Materiale orientuese të hartuara sipas fushave të zhvillimit përshtatur me njohuri akademike sipas planit edukativ individual (PEI).
- Hartimi i planit do të bazohet në fushat e të nxënësve dhe kompetencat kyçe:

Fushat e të nxënit:

Gjuha dhe komunikimi; matematikë; shkencat e natyrës; shoqëria dhe mjedisi; arte; edukim fizik, sporte dhe shëndet; teknologji dhe tik.

Kompetencat kyçe:

Çdo fushë ka rezultatet e saj të të nxënit që i përkasin zhvillimit të kompetencave kyçe: kompetenca e gjuhës dhe komunikimit dhe të shprehurit, qytetare, e të menduarit, digjitale, personale, kompetenca për jetën, sipërmarrje dhe mjedis.

- Mësuesit ndihmës në bashkëpunim me mësuesit e klasës në arsim fillor dhe mësuesit sipas lëndëve AMU, bazuar në planifikimin e periudhës dhe PEI-it, do të hartojnë orë të integruara.
- Planifikim javor për komunikim online mësues-nxënës
- *Publikimi i materialeve didaktike/ udhëzuese në bazë të fushave të zhvillimit të cilat mund të përzgjidhen nga prindërit për të punuar me fëmijët e tyre në kushtet e shtëpisë.*
- Materiale praktike të përgatitura nga puna me mësuesit ndihmës në bashkëpunim me mësuesin e klasës apo mësuesin lëndor.
- *Aktivitete orientuese në funksion të nxitjes së zhvillimit psiko-social dhe të të nxënit.*
- Materiale praktike për zhvillimin e motorikës fine dhe globale, nëpërmjet videove të realizuar nga mësuesit ndihmës dhe punonjësit e shërbimit psiko – social;

- *Ilustrime praktike ushtrimesh me synim përmirësimin e motorikës globale dhe fine.*
- *Modele lojrash zhvillimore dhe argëtuese;*
 - *Nxitja e aftësive sociale, ndërvepruese.*
 - *Nxitja e imagjinatës dhe aftësive për të ndjekur komandat.*

III. Mbështetje psiko-emocionale për prindërit.

- *Materiale orientuese për menaxhimin e sjelljes së fëmijëve, në kushtet e distancimit fizik;*
 - *Materiale për aktivitete zhvillimore në kushtet e shtëpisë.*
 - *Materiale për aktivitete fizike të përshtatshme me kushtet e shtëpisë.*
 - *Shembuj aktivitetimesh relaksuese dhe argëtuese.*

IV. Rubrika e këshillimit

Rubrika e këshillimit on line do të jetë në funksion të prindërve për problematikat apo vështirësitë që ata hasin në përditshmërinë e tyre (kjo ndihmë do të ofrohet nga psikolog të shërbimit psiko-social të trajnuar për fëmijët me AK).

- *Këshillim nëpërmjet komunikimit verbal për elementë të përditshmërisë të fëmijëve me AK.*
- *Komunikim me specialistët të realizuar nëpërmjet pyetjeve – përgjigjeve.*
- *Ofrimi i mbështetjes psiko-emocionale dhe orientuese për prindërit apo familjarë të ngushtë të nxënësve me AK.*

###

Materialet të jenë të ndara sipas moshës së nxënësve dhe të jenë gjithëpërfshirëse.

Botime të përditësuara nga faqet zyrtare ndërkombëtare të fushës.

Video të përgatitura me punët e fëmijëve, mësuesve ndihmës dhe psikologëve.

Punimet e realizuara nga nxënësit me aftësi të kufizuara, do të paraqiten si një mjet motivimi / promovimi i punës dhe familjarëve të tyre duke ruajtur privatësinë dhe kofidencialitetin.